



Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16) dhe nenit 65-dh, paragrafi 7 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15 dhe 190/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë mori:

V E M D I M

metodologjinë e zhvillimit të planit për fuqizimin e bankave me rëndësi sistemore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet metodologjia për përgatitjen e planit për fuqizimin të bankës, i cili në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) është identifikuar si bankë me rëndësi sistemore.

Metodologjia e paragrafit 1 të kësaj pike përmban:

- elementet e planit për fuqizim;
- mënyrën dhe afatet e dorëzimit të planit për fuqizim në Bankën Popullore;
- mënyrën dhe vlerësimin e planit për fuqizim, nga Banka Popullore.

2. Shprehje të caktuara të përdorura në këtë vendim kanë këtë kuptim:

2.1. "Plan për fuqizim" (në tekstin e mëtejme: plani) nënkupton një plan që parashikon masat dhe aktivitetet që do të ndërmerre banka me rëndësi sistemore (në tekstin e mëtejme: banka) për të rivendosur funksionimin normal dhe gjendjen financiare, në kushtet e shqetësimeve serioze financiare.

2.2. "Çrregullim serioz financiar" nënkupton situatat e shkaktuara nga ngjarje të brendshme ose të jashtme që mund të kërcënojnë funksionimin normal të bankës, d.m.th. ecurinë e mëtejshme të aktiviteteve financiare të saj.

2.3. "Funksione kritike" nënkupton produktet, shërbimet ose aktivitetet e bankës, ndërprerja e të cilave, brenda ose jashtë vendit, për shkak të rëndësisë sistemore të bankës, por veçanërisht për shkak të vështirësive në zëvendësimin e këtyre produkteve, shërbimeve ose aktiviteteve, sipas të gjitha gjasave do të shkaktonte ndikim negativ në ekonominë reale ose çrregullim të stabilitetit financiar.

2.4. "Linja kryesore të biznesit" nënkupton linjat e biznesit dhe shërbimet që lidhen me to, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në të hyrat, fitimin ose vlerën e bankës ose grupit të cilit i përket.

2.5. "Mundësi fuqizimi" nënkupton aktivitetet, kontratat, masat ose strategjitë e bankës që mbulohen nga plani dhe mundësojnë rivendosjen e funksionimit normal ose të gjendjes financiare, në kushtet e shqetësimeve të rënda financiare.

2.6. "Ndryshim i rëndësishëm" nënkupton çdo ndryshim që mund të ndikojë në aftësinë për të zbatuar planin ose për të zbatuar ndonjë nga mundësitë e fuqizimit të parashikuara në plan.

II. ELEMENTE TË PLANIT PËR FUQIZIMIN

3. Plani përfshin të paktën këto elemente:
 - Përmbledhjen e planit, në përputhje me pikën 4 të këtij vendimi;
 - Strukturën organizativ në lidhje me krijimin, miratimin, zbatimin dhe përditësimin e planit, në përputhje me pikat 5, 6 dhe 7 të këtij vendimi;
 - Analizën strategjike, në përputhje me pikat 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të këtij vendimi;
 - Komunikimin e planit, në përputhje me pikat **Ерроp! Референце соурце нот фоунд.** dhe 18 të këtij vendimi;
 - Veprimtaritë përgatitore që duhet të ndërmerren për krijimin e kushteve të zbatimit të planit, në përputhje me pikën 19 të këtij vendimi.

Krahas elementeve të paragrafit 1 të kësaj pike, plani duhet të përmbajë edhe tregues të çrregullimit të gjendjes ose të operacioneve financiare, në përputhje me pikat 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27 të këtij vendimi, si dhe simulimet, në përputhje me pikat 28, 29, 30 dhe 31 të këtij vendimi.

Përmbledhje e planit

4. Përmbledhja e planit duhet të përmbajë:
 - pasqyrim të shkurtër të të gjithë elementeve të planit të pikës 3 të këtij vendimi;
 - pasqyrim të shkurtër të ndryshimeve të rëndësishme që kanë ndodhur në bankë, në grupin të cilit i përket, në mjedisin ose planin, në periudhën pas dorëzimit të tij të fundit në Bankën Popullore.

Struktura organizative

5. Informacionet për strukturën organizative duhet të paktën të përmbajnë një përshkrim të hollësishëm të:

5.1. Procedurës së përpilimit, miratimit, zbatimit dhe përditësimit të planit, duke përfshirë një përshkrim se si plani përfshihet në sistemin e qeverisjes së korporatës dhe në sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut. Në këtë pjesë, shënohen personat dhe njësitë organizative të përfshira në përpilimin, miratimin, zbatimin dhe përditësimin e secilës pjesë të planit, jepet një përshkrim i rolit të tyre (detyrat dhe përgjegjësitë) dhe personi/personat që janë përgjegjës për identifikimin në kohë të nevojës për përditësimin e planit. Nëse banka është pjesë e një grupi, ky kjo pjesë përshkruan gjithashtu masat dhe aktivitetet e marra në nivel grupi që sigurojnë koordinimin dhe harmonizimin e mundësive të fuqizimit në nivel grupi dhe në nivel të një anëtar individual të grupit.

5.2. Mënyra dhe afatet e vlerësimit të planit nga Shërbimi i Auditimit të Brendshëm, Shoqëria e Auditimit ose Këshilli i Menaxhimit të Rrezikut i Bankës.

5.3. Aktet e brendshme (rregullat, procedurat, etj.) për zbatimin në kohë të mundësive të fuqizimit, të cilat të paktën duhet të përfshijnë:

- përshkrimin e hollësishëm të treguesve të pikave 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27 të këtij vendimi;
- përshkrimin e hollësishëm të procesit për të vendosur se cilën mundësi fuqizimi do të ndërmarrë banka, në përputhje me masat dhe aktivitetet e parashikuara në plan, duke përfshirë të paktën përshkrimin e: rolit dhe detyrave të personave të përfshirë në procesin e vendimmarrjes, procedurat që duhen ndjekur në procesin e vendimmarrjes dhe afatin gjatë të cilit duhet të merret një vendim për të ndërmarrë një mundësi specifike fuqizimi, si dhe afatet dhe mënyrën e raportimit në Bankën Popullore.

5.4. Përshkrimi i sistemit të raportimit i autoriteteve të bankës, duke përfshirë informacionet që do t'u mundësojë autoriteteve të bankës të bëjnë një zgjedhje në kohë dhe të duhur të mundësive të fuqizimit të parashikuara në plan.

5.5. Aktet e tjera të brendshme (rregullat, procedurat etj.) që i referohen përpilimit, zbatimit, miratimit dhe përditësimit të planit.

6. Planin e voton Këshilli Drejtues i bankës, ndërkaq e mirato Këshilli Mbikëqyrës.

Këshilli drejtues i bankës është përgjegjës për strukturën organizative në lidhje me planin, veçanërisht nga aspekti i ndarjes së përgjegjësisë të njësive organizative veçmas, këshillave ose personave në bankë për përpilimin, zbatimin dhe përditësimin e planit, në përputhje me pikën 5 të këtij vendimi.

7. Banka është e detyruar të përditësojë planin të paktën një herë në vit, ndërkaq edhe më shpesh, pas kërkesës së Bankës Popullore, si dhe në rast të ndryshimeve të rëndësishme në bankë, grupin ose mjedisin të cilit i përket.

Banka është e detyruar që, me akt të brendshëm, të rregullojë mënyrën e përpilimit, zbatimit dhe dinamikën e përditësimit të planit, si dhe rastet e ndryshimeve të rëndësishme nga paragrafi 1 i kësaj pike.

Analizë strategjike

8. Në analizën strategjike, banka është e detyruar të identifikojë linjat bazë të biznesit dhe funksionet kritike dhe të përcaktojë veprimet që duhet të ndërmarrë për të vazhduar zbatimin e tyre në kushtet e çrregullimit të pozicionit të saj financiar.

Gjatë identifikimit të funksioneve kritike, banka duhet të marrë parasysh ndikimin që do të kishte ndërprerja e kryerjes së këtij funksioni në klientët e bankës ose në stabilitetin financiar, si dhe mundësinë që funksioni të merret nga një person tjetër juridik i pranishëm në tregun e këtij funksioni kritik, në të njëjtin vëllim dhe cilësi, me shpenzime të pranueshme për klientin dhe brenda një afati të arsyeshme.

9. Në analizën strategjike, banka është e detyruar të përfshijë të paktën:
- informacionet për bankën, në përputhje me pikën 10 të këtij vendimi;
 - përshkrimin e mundësive të fuqizimit, në përputhje me pikat 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të këtij vendimi.

10. Informacionet për bankën duhet të përfshijnë të paktën:

10.1. Përshkrimin e karakteristikave kryesore të bankës, e sidomos:

- përshkrimin e hollësishëm të strategjisë së biznesit dhe strategjisë së menaxhimit të rrezikut;
- listën e vendeve në të cilat i kryen kryesisht aktivitetet e saj;
- përshkrimin e hollësishëm të linjave bazë të biznesit dhe të funksioneve kritike, së bashku me arsyet për identifikimin e funksioneve të veçanta kritike.

10.2. Nëse persona të tjerë (anëtarë të të njëjtit grup, shoqëri për shërbime bankare ndihmëse ose persona të tjerë) janë të përfshirë në kryerjen e linjave bazë të biznesit dhe të funksioneve kritike, jepet një pasqyrim i përfshirjes së këtyre personave në kryerjen e linjave bazë të biznesit dhe të funksioneve kritike dhe një përshkrim të ndikimit të këtyre personave në zbatimin e planit.

10.3. Nëse banka është anëtare e një grupi, jepet një përshkrim i ndërlidhjes së anëtarëve individualë, bazuar në ekspozimet e rëndësishme, marrëveshjet për detyrimet e marra, marrëveshjet e mbështetjes financiare, etj.

10.4. Përshkrimi i ndërlidhjes së bankës me palët e treta, i cili përfshin informacionet për ekspozimet dhe detyrimet e rëndësishme dhe shërbimet e rëndësishme që banka i shfrytëzon nga palët e treta.

11. Banka është e detyruar të identifikojë mundësitë e fuqizimit dhe të përshkruajë secilën mundësi, në përputhje me kërkesat e pikave 12, 13, 14, 15 dhe 16 të këtij vendimi, duke përfshirë përshkrimin e masave që do të merreshin për çdo mundësi.

12. Plani duhet të përfshijë të gjitha mundësitë e fuqizimit, pavarësisht nëse mundësia përkatëse kërkon një ndryshim në operacionet ekzistuese të biznesit të bankës.

Plani nuk duhet të parasheh qasjen në, si dhe shfrytëzimin e mjeteve nga buxheti i Republikës së Maqedonisë.

13. Çdo mundësi fuqizimi duhet të përmbajë aktivitetet dhe masat që do të mundësojnë fuqizimin e operacioneve normale dhe të pozicionit financiar të bankës, objektivi kryesor i të cilave është ruajtja e linjave bazë të biznesit dhe e funksioneve kritike, e të paktën:

- aktivitete dhe masa, qëllimi kryesor i të cilave është ruajtja ose arritja e një niveli të përshtatshëm të mjeteve vetjake në nivel individual ose të konsoliduar, nëpërmjet rikapitalizimit nga burimet e jashtme ose nëpërmjet masave të brendshme për të përmirësuar pozicionin e aftësisë së pagesës të bankës;
- aktivitete dhe masa që i ofrojnë bankës qasjen në burimet e financimit në kushte emergjente, për të vazhduar aktivitetet dhe shlyerjet në kohë të detyrimeve, duke shënua gjithashtu burimet e mundshme të financimit, vlerësimin e mjeteve që do të mund të shfrytëzoheshin si kolateral dhe vlerësimin e mundësive për rishpërndarjen e mjeteve likuide brenda grupit ose ndërmjet linjave individuale të biznesit;
- aktivitete dhe masa për të reduktuar profilin e rrezikut dhe borxhin ose për të ndryshuar linjat bazë të biznesit, duke përfshirë analizën e mundësisë së shitjes së pronës, investimet në persona të tjerë juridikë ose linja biznesi individuale, në varësi të asaj që është e zbatueshme për bankën;
- aktivitete dhe masa për ristrukturimin vullnetar të detyrimeve.

Nëse një mundësi specifike fuqizimi nuk përfshin asnjë nga aktivitetet e paragrafit 1 të kësaj pike, plani duhet të përmbajë një shpjegim pse ai aktivitet është i përjashtuar, pra nuk është i rëndësishëm për bankën.

14. Çdo mundësi fuqizimi duhet të përfshijë vlerësimin e ndikimit të tij, i cili duhet të mbulojë të paktën:

- vlerësimi i ndikimit në aktiven, aftësinë e pagesës, likuiditetin, mundësinë e financimit, profitabilitetin dhe funksionimin e bankës;
- vlerësimi i ndikimit në mjedisin e jashtëm ose në sistemin financiar, duke marrë parasysh funksionet kritike të kryera nga banka, si dhe vlerësimin e ndikimit në aksionarët, klientët, depozituesit ose kreditorët e tjerë, palët e tjera kontraktuese ose grupin si një tërësi (nëse banka është anëtare e grupit);
- supozimet në bazë të të cilave janë bërë vlerësimet e paragrafëve 1 dhe 2 të kësaj pike.

15. Çdo mundësi fuqizimi duhet të përmbajë vlerësimin e mundësisë së zbatimit të tij, i cili përfshin të paktën:

- vlerësimin e rreziqeve që lidhen me mundësinë, me përshkrimin e hollësishëm të kufizimeve të mundshme të rëndësishme që do të reduktonin efikasitetin ose zbatimin në kohë të planit;
- nëse banka është anëtare e një grupi, një analizë e kufizimeve të mundshme për zbatimin efikas të mundësisë së fuqizimit, që burojnë nga struktura e grupit ose nga marrëdhëniet brenda grupit, veçanërisht kufizimet në transferimin e shpejtë të mjeteve ose pagesa/shlyerja e detyrimeve dhe mjeteve brenda grupit;
- përshkrimin e zgjidhjeve të mundshme për heqjen ose tejkalimin e kufizimeve të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij paragrafi.

Për qëllimet e paragrafit 1 të kësaj pike, kufizimet e rëndësishme i referohen çdo faktori që mund të ndikojë negativisht në zbatimin në kohë të mundësisë së fuqizimit, si çdo rrezik ligjor, operacional, biznesi, financiar ose reputacioni.

16. Çdo mundësi fuqizimi duhet të lidhet qartë me një simulim specifik, në përputhje me pikat 28, 29, 30 dhe 31 të këtij vendimi, duke përshkruar mënyrën se si mundësia e fuqizimit do të mundësonte funksionimin e pandërprerë të bankës dhe qasjen e pandërprerë në tregjet financiare.

Komunikimi i planit

17. Banka është e detyruar që me akt të brendshëm të përcaktojë mënyrën e komunikimit të planit brenda bankës, me aksionarët, Bankën Popullore dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse ose rregullatore.

18. Planit duhet të përfshijë gjithashtu një metodë komunikimi në rast të zbatimit të një ose më shumë masave, me ç'rast mund të parashikohet një mënyrë e ndryshme komunikimi në mundësitë e ndryshme të fuqizimit.

Aktivitete përgatitore

19. Plani duhet të përmbajë aktivitetet përgatitore të ndërmarra ose që do të ndërmerren nga banka për të krijuar kushtet e zbatimit të planit ose rritjen e efikasitetit të tij.

Në plan duhet të përcaktohen edhe afatet e realizimit të aktiviteteve përgatitore të paragrafit 1 të kësaj pike.

Aktivitetet e paragrafit 1 të kësaj pike përmbajnë gjithashtu të gjitha aktivitetet që janë të nevojshme për heqjen e kufizimeve të zbatimit efikas të mundësive të fuqizimit.

Tregues të çrregullimeve në pozicionin financiar ose punën e bankës

20. Banka është e detyruar që në plan të përcaktojë tregues që tregojnë çrregullim të mundshëm të gjendjes së saj financiare ose të veprimtarisë së saj.

Për çdo tregues të përcaktuar në këtë kapitull të vendimit, banka duhet të vendosë një vlerë kufizimi, tejkalimi i së cilës do të nënkuptonte ndërmarrjen e një mundësie të caktuar fuqizimi.

Me përjashtim të paragrafit 2 të kësaj pike, nëse autoritetet e bankës e konsiderojnë të përshtatshme për situatën në të cilën ndodhet banka, banka mund të:

- ndërmarrë një masë ose aktivitet nga plani edhe kur nuk tejkalohet vlera e kufizimit e një treguesi të caktuar; ose
- mos marrë një masë ose aktivitet nga plani, pavarësisht tejkalimit të vlerës së kufizimit.

Banka është e detyruar që në afat prej pesë ditësh ta informojë Bankën Popullore për rastet sipas paragrafit 3 të kësaj pike, me arsyetimin e duhur për zgjedhjen.

21. Banka përfshin detyrimisht tregues në plan, për të paktën këto kategori e që lidhen me operacionet e saj:

21.1. Treguesit e kapitalit: shkalla e kapitalit të rregullt bazë, shkalla e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe shkalla e kreditimit. Banka përcakton vlerën e kufizimit të këtyre treguesve në një nivel që është mbi kërkesat minimale ligjore në lidhje me kapitalin bazë të rregullt dhe mjetet vetjake dhe mbi shumën e kapitalit të brendshëm. Gjatë përcaktimit të vlerës së kufizimit të këtyre treguesve, banka duhet të marrë parasysh faktin që, zakonisht, duhet një periudhë më e gjatë kohore për të zbatuar masat për përmirësimin e pozicionit të aftësisë së pagesës dhe se këto masa janë më të ndjeshme ndaj lëvizjeve të tregut.

21.2. Treguesit e likuiditetit: pjesëmarrja e aktives likuide në totalin e aktives dhe shpenzimet e financimit në tregun ndërbankar të parasë.

21.3. Treguesit e profitabilitetit: shkalla e kthimit të aktives, shkalla e kthimit të kapitalit dhe treguesit e efikasitetit operacional.

21.4. Treguesit e cilësisë së aktives: shkalla e rritjes së kredive me probleme, pjesëmarrja e kredive me probleme në totalin e kredive dhe shkalla e mbulimit të kredive me probleme nëpërmjet zhvlerësimit të kredive me probleme.

22. Krahas treguesve të pikës 21 të këtij vendimi, banka është e detyruar të përdorë tregues makroekonomikë (p.sh. shkallën e rritjes së produktit të brendshëm bruto ose uljen e klasifikimit kreditor të shtetit) dhe tregues të tregut (p.sh. ndryshimi i kursit valutor; çmimi i aksioneve, normat e interesit, etj.).

23. Me përjashtim të pikave 21 dhe 22 të këtij vendimi, banka mund të zëvendësojë ndonjë nga treguesit e përmendur ose ta përjashtojë atë nga plani, nëse vlerëson se treguesi nuk është i rëndësishëm për profilin e rrezikut, madhësinë dhe/ose ndërlikueshmërinë e tij, për të cilën paraqet arsyetim përkatës në Bankën Popullore, si njoftim të veçantë ose si pjesë të planit.

Pavarësisht paragrafit 1 të kësaj pike, banka është e detyruar të përfshijë të paktën një tregues në kategoritë e pikës 21 të këtij vendimi.

24. Planit duhet të përmbajë arsyetimin për përzgjedhjen e secilit tregues dhe për vlerën e kufizimit të përcaktuar për atë tregues.

25. Treguesit dhe vlerat e kufizimit të përcaktuara duhet:

- të jenë të përshtatshme me modelin e biznesit, strategjinë dhe profilin e rrezikshmërisë të bankës;
- të jetë i përshtatshëm për madhësinë dhe ndërlikueshmërinë e aktiviteteve të bankës;
- të mundësojnë vendimmarrje në kohë për ndërmarrjen e një mase apo aktiviteti nga plani;
- të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të rrezikut dhe treguesit e përfshirë në planin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit në kushte emergjente, si dhe me planin e vazhdimësisë së biznesit.

Gjatë përcaktimit të vlerës së kufizimit të secilit tregues, duhet të merret parasysh vëllimi dhe shpejtësia e arritjes së vlerës së kufizuar.

26. Gjatë përditësimit të rregullt të planit në përputhje me pikën 7 të këtij vendimi, banka është e detyruar të shqyrtojë arsyetimin e përdorimit të treguesve të përzgjedhur dhe vlerat e tyre të kufizimit.

27. Gjatë përcaktimit të treguesve sasiore nga ky kapitull, banka duhet të krijojë një sistem për monitorimin e vazhdueshëm të vlerës së treguesve individualë, në mënyrë që të informojë menjëherë autoritetet e bankës për mundësinë që një tregues i caktuar të arrijë vlerën e tij të kufizimit.

Simuline

28. Banka është e detyruar të përcaktojë të paktën katër simulime për çrregullime të rënda financiare, në bazë të të cilave do të testojë efikasitetin e çdo mundësie të fuqizimit dhe përshtatshmërinë e treguesve të përcaktuar.

Lloji dhe numri i simulimeve nga paragrafi 1 i kësaj pike përcaktohen duke marrë parasysh llojin, vëllimin dhe ndërlikueshmërinë e veprimtarive të kryera nga banka dhe mjedisin në të cilin ajo operon.

Banka është e detyruar të kryejë testimin sipas paragrafit 1 të kësaj pike të paktën një herë në vit.

29. Simulimet nga pika 28 e këtij vendimi duhet të përfshijnë të paktën goditjet sistemore dhe goditjet që janë specifike për operacionet e bankës, si p.sh.:

- çrregullimet në funksionimin e një aktiviteti të caktuar, domethënës për sistemin bankar dhe për bankën, që do të ndikonte negativisht në stabilitetin financiar;
- reduktimi i likuiditetit të tregut ndërbankar;
- rritja e rrezikut të vendit ose dalja e konsiderueshme e kapitalit nga vendi ku operon banka;
- lëvizjet e pafavorshme çmimesh në një ose më shumë tregje;
- lëvizjet e pafavorshme makroekonomike;
- dëmtimi serioz i reputacionit të bankës ose grupit të cilit i përket;
- daljet e konsiderueshme të mjeteve likuide nga banka;
- lëvizjet e pafavorshme në çmimet e mjeteve (letra me vlerë, pasuri të paluajtshme, etj.) që janë të rëndësishme për bankën ose grupin të cilit i përket;
- humbjet e konsiderueshme kreditore;
- humbjet e konsiderueshme për shkak të realizimit të rrezikut operacional; dhe/ose
- ndërprerja e veprimtarisë së një pale tjetër kontraktuese të rëndësishme për bankën.

30. Çdo simulim individual duhet të plotësojë këto kushte:

- të jetë i rëndësishëm për bankën, pra të bazohet në goditjet që janë më të rëndësishme për bankën ose grupin të cilit i përket, duke marrë parasysh modelin e saj të biznesit dhe mënyrën e financimit, aktivitetet e saj financiare, madhësinë dhe lidhjen me institucionet financiare të tjera ose me sistemin financiar në tërësi, si dhe dobësitë dhe mangësitë e identifikuar në funksionimin e bankës ose grupit të cilit i përket;
- goditjet e parashikuara janë të një natyre të tillë që, nëse masat e parashikuara në plan nuk ndërmerren në kohë, banka ose grupi të cilit i përket mund të pushojë së punuari;
- të bazohet në goditjet që janë të jashtëzakonshme, por të mundshme.

31. Çdo simulim duhet, për aq sa është e mundur, të përfshijë efektet e goditjeve të parashikuara në atë simulim në mjetet vetjake, likuiditetin, profilin e rrezikut dhe reputacionin e bankës dhe në pjesëmarrjen e saj të qetë në sistemet e pagesave dhe të shlyerjeve.

III. MËNYRA DHE AFATET E DORËZIMIT TË PLANIT PËR FUQIZIM

32. Afati i dorëzimit të planit në Bankën Popullore është gjashtë muaj pas datës në të cilën Banka Popullore e ka njoftuar bankën se është identifikuar si bankë me rëndësi sistemore, në përputhje me metodologjinë e Bankës Popullore për identifikimin e bankave me rëndësi sistemore.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, banka që për herë të parë është identifikuar si bankë me rëndësi sistemore është e detyruar që planin t'ia dorëzojë Bankës Popullore brenda nëntë muajve nga data në të cilën Banka Popullore e ka njoftuar që u identifikua si bankë me rëndësi sistemore.

Nëse Banka Popullore kërkon ndryshime në plan, në përputhje me kreun IV të këtij vendimi, banka është e detyruar që planin e ri t'ia dorëzojë Bankës Popullore brenda afatit të caktuar në njoftimin e Bankës Popullore.

33. Banka e paraqet planin në formë të shkruar dhe elektronike.

IV. MËNYRA E VLERËSIMIT TË PLANIT PËR FUQIZIM

34. Banka Popullore është e detyruar që në afat prej gjashtë muajsh nga data e dorëzimit të planit të vlerësojë nëse plani i dorëzuar i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë vendim, pra të vlerësojë nëse:

- zbatimi i masave dhe i aktiviteteve të parashikuara në plan do të mundësojë ruajtjen ose rivendosjen e funksionimit normal dhe gjendjes financiare të bankës ose grupit, duke marrë parasysh aktivitetet përgatitore që janë ndërmarrë ose janë planifikuar të ndërmerren;
- plani dhe mundësitë e veçanta të fuqizimit do të mund të zbatohen shpejt dhe me efikasitet në kushte goditjesh, pa shkaktuar një ndikim të rëndësishëm negativ në sistemin financiar.

Vlerësimin nga paragrafi 1 të kësaj pike e bën Banka Popullore duke vlerësuar plotësinë, cilësinë, mundësinë e zbatimit të planit dhe përshtatshmërinë e mundësive të fuqizimi, duke marrë parasysh strukturën e mjeteve vetjake të bankës dhe burimet e financimit, ndërlikueshmërinë e strukturës së tij organizative dhe profilin e rrezikut.

35. Vlerësimi i plotësisë së planit përfshin këto aspekte:

- nëse plani përfshin të paktën elementet e parashikuara në kreun II të këtij vendimi;
- nëse plani përmban të dhëna dhe informacione të përditësuara, kryesisht në lidhje me ndryshimet e rëndësishme në bankë ose në persona të tjerë të përfshirë në plan, veçanërisht në strukturën organizative, operacionet afariste ose pozicionin financiar, pas dorëzimit të fundit të planit në Bankën Popullore;
- nëse plani përfshin një analizë të mundësisë se kur dhe si banka mund t'i drejtohet Bankës Popullore për marrjen e një kredie si mjet të fundit, si dhe nëse janë përcaktuar mjetet që do të përdoren si kolateral për kredinë;
- nëse plani përmban një përzgjedhje të përshtatshme simulimesh për goditje serioze makroekonomike dhe financiare që janë të rëndësishme për operacionet e bankës;
- nëse plani përmban tregues në bazë të të cilëve mund të përcaktohet kur është e nevojshme të ndërmerren masa në përputhje me planin;
- nëse plani parashikon mundësinë e mbështetjes financiare brenda grupit, po qe se banka është anëtare e grupit.

36. Banka Popullore, gjatë vlerësimit të cilësisë së planit të dorëzuar vlerëson këto kritere:

36.1. Qartësia e dispozitave të planit, e cila konsiderohet e arritur nëse:

- plani është shkruar në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme;
- përcaktimet dhe përshkrimi i aktiviteteve janë të qarta dhe kanë të njëjtin kuptim në të gjithë planin;
- supozimet dhe metoda e vlerësimit të pozicioneve individuale janë shpjeguar ashtu siç duhet;
- udhëzimi për dokumente, të dhëna dhe informacione që nuk përfshihen në plan, si dhe shtojcat të planit, nuk përbën pengesë për identifikimin e mundësive të përshtatshme të fuqizimit.

36.2. Rëndësia e informacionit të përfshirë në plan, i cili konsiderohet që është arritur, nëse informacioni identifikon mundësitë e duhura të fuqizimit.

36.3. Gjithëpërfshirja e planit, e cila konsiderohet që është arritur, nëse merret parasysh natyra e aktiviteteve të bankës dhe të personave të tjerë të përfshirë në plan, madhësia dhe lidhja e tyre me persona ose grupe të tjera dhe me sistemin financiar në tërësi.

37. Banka Popullore gjatë vlerësimit të mundësisë së zbatimit të planit vlerëson këto kritere:

- përfshirja e planit të menaxhimit korporativ dhe të sistemit të menaxhimit të rrezikut të bankës;
- plani përmban një numër të mjaftueshëm mundësish të arritshme dhe të zbatueshme të fuqizimit, të cilat ofrojnë një bazë për bankën ose grupin për të përballuar goditjet e ndryshme në mënyrë të shpejtë dhe efikase;
- mundësitë e fuqizimit parashikojnë veprime të duhura për t'u përballur me goditjet makroekonomike ose financiare;
- afati kohor i planifikuar për zbatimin e mundësive është realist dhe është marrë parasysh gjatë përpilimit të procedurave për zbatimin e planit;
- u testua përshtatshmëria e simulimeve të ndryshme;
- supozimet e parashikuara në plan dhe në secilin prej mundësive të fuqizimit janë realiste dhe të arritshme.

38. Banka Popullore, gjatë vlerësimit të mundësive të fuqizimit që banka ka përfshirë në plan, vlerëson:

- nëse zbatimi në kohë dhe efikas i planit ose i një mundësie specifike të fuqizimit është i mundshëm në kushtet e goditjeve serioze makroekonomike ose financiare;
- nëse plani ose mundësia specifik i fuqizimit është e mundshme të zbatohet në një mënyrë që do të arrinte objektivat, pa shkaktuar një ndikim të rëndësishëm negativ në sistemin financiar;
- masën në të cilën mundësitë e fuqizimit të bankës mund të bien ndesh me mundësinë e fuqizimit të institucioneve ose grupeve të tjera që kanë karakteristika të ngjashme (modeli i ngjashëm i biznesit, strategjia e biznesit, fusha e aktiviteteve që ata kryejnë), në rast të zbatimit të njëkohshëm të planeve për fuqizimin nga ana e shumë institucioneve apo grupeve financiare;
- shkalla në të cilën zbatimi i njëkohshëm i mundësive të fuqizimit nga disa institucione ose grupe mund të ketë efekte negative në zbatimin e mundësive të parashikuara të fuqizimit.

39. Nëse Banka Popullore vlerëson se plani i paraqitur nga banka ka mangësi ose kufizime domethënëse për zbatimin e tij, e njofton bankën me shkrim dhe i jep mundësinë që brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, të paraqesë mendim për mangësitë ose kufizimet e konstatuara.

Nëse banka nuk e paraqet mendimin brenda afatit sipas paragrafit 1 të kësaj pike ose nëse Banka Popullore konstaton se mendimi nuk jep shpjegim të duhur për mangësitë ose kufizimet e konstatuara për zbatimin e planit, do ta udhëzojë bankën që brenda dy muajve të dorëzojë një plan të ndryshuar në të cilin do të mënjanohej mangësitë ose kufizimet e identifikuara.

40. Nëse banka nuk e dorëzon planin e ndryshuar ose nëse mangësitë ose kufizimet e identifikuar për zbatimin e tij nuk janë hequr me planin e ndryshuar, Banka Popullore mund të marrë çdo masë, në përputhje me ligjin.

41. Nëse Banka Popullore vlerëson se plani i plotëson kërkesat e përcaktuara me këtë vendim ose nëse pranon mendimin e bankës të paraqitur në përputhje me pikën 39, paragrafi 1 të këtij vendimi, do ta njoftojë bankën se plani është pranuar.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

42. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

43. Me përjashtim të pikës 32, paragrafët 1 dhe 2 të këtij vendimi, banka që është njoftuar nga Bankën Popullore deri më 30 prill 2017, se është identifikuar si bankë me rëndësi sistemore, është e detyruar që planin t'ia dorëzojë Bankës Popullore deri më 30 prill 2017, e më së voni më 30 qershor 2018.

O nr. 02-15/II-7/2017
27 shkurt 2017
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov